

Shkaqet dhe pasojat e shkurorëzimeve në Komunën e Ferizajt

Shqipe Shaqiri

Abstrakt

Shkaqet dhe pasojat e shkurorëzimeve në Komunën e Ferizajt kanë qenë objekt i studimit në këtë hulumtim. Është bërë identifikimi i faktorëve relevantë dhe shkaktarëve më të mëdhenj të shkurorëzimit në Komunën e Ferizajt si dhe efektet më të mëdha që ka ai të vetë të shkurorëzuarit, familjarët dhe shoqërinë tonë. Hulumtimi është përqendruar tek institucionet relevante për shkurorëzimin në aspektin e faktorëve kryesorë dhe pasojave, si Gjykata Themelore e Ferizajt dhe Qendra për Punë Sociale, gjithashtu edhe të vetë të shkurorëzuarit që jetojnë në Ferizaj. Qëllimi i këtij hulumtimi është të krijojë pasqyrë të saktë rreth rrethanave që shkaktojnë shkurorëzimin dhe situatave me të cilat përballet shoqëria jonë, si dhe të bëjë një identifikim për bartësit më të mëdhenj të pasojave dhe efektet e tij. Është analizuar në veçanti edhe pozita e femrave dhe meshkujve duke bërë krahasimin mes tyre në shkurorëzimet e bëra.

Duke qenë se në lidhje shumë të afërt me të shkurorëzuarit janë edhe fëmijët që kanë prindër të ndarë, i është kushtuar theks i veçantë i ndikimit të ndarjes së prindërve në edukimin, kujdesin, ushqimin dhe sjelljen e tyre.

Fjalët kyçe: shkurorëzimet, shkaqet e shkurorëzimit, pasojat e shkurorëzimit, fëmijët, gjendja ekonomike, Komuna e Ferizajt

Hyrje

Shkurorëzimi, shkaqet dhe pasojat e tij në Komunën e Ferizajt janë objekt hulumtimi i përgjithshëm i këtij punimi. Do të analizohen faktorët dhe rrethanat kryesore shoqërore të cilat ndikojnë në rastet e shkurorëzimit në komunën tonë si dhe pasojat më të mëdha që sjell.

Sipas publikimeve të Agjencisë të Statistikave të Kosovës në Komunën e Ferizajt në vitin 2013 janë shkukurëzuar gjithsejtë 83 çifte për dallim nga viti 2012 ku kanë qenë 55, dhe nga viti 2011 me 64 raste të shkukurëzimit. Përmes këtij hulumtimi do të mundohemi të zbardhim arsyet përse ky numër është në rritje, të identifikojmë faktorët kryesorë që kanë afektuar të bëhen këto shkukurëzime, dhe një theks të veçantë do t'i kushtojmë edhe pasojave që kanë këto raste në shoqërinë tonë në përgjithësi dhe në familjet ku ndodhin këto raste.

Për shkukurëzimin në Kosovë, përveç institucioneve përkatëse të cilat nxjerrin statistika dhe raportojnë e dokumentojnë për këto raste, viteve të fundit janë shkruar shumë artikuj, janë bërë kërkime e të tjera rreth kësaj dukurie për të kuptuar më qartë se përse ndodh dhe çfarë pasojash lë. Përmes këtij hulumtimi ne do të zbërthejmë dhe analizojmë këto aspekte për Komunën e Ferizajt duke konsultuar legjislacionin që rregullon këtë çështje, të dhënat zyrtare dhe aspektet shkencore juridike që trajtojnë shkukurëzimin.

Problemi kërkimor

Shkukurëzimi është zgjidhja e një martese të vlefshme gjatë jetës bashkëshortore për shkaqe të parapara me ligj, dhe në procedurë ligjore dhe me aktgjykim të organit kompetent shtetëror. Sipas Ligjit të Kosovës për Familjen njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkukurëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente. Gjithashtu nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkukurëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për shkukurëzim me marrëveshje. Sipas këtij ligji të drejtën për të kërkuar shkukurëzim bashkëshortët e kanë kur marrëdhënia martesore ka çrregullime serioze apo të vazhdueshme ose kur për arsye të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme.

Ligji për Familjen i Kosovës rendit shkaqet e shkukurëzimit, mes tjerash: jetesa e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit,

keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme.

Sa i përket shkaqeve vlen të theksohet se ato janë nga më të ndryshmet duke filluar nga ato ekonomike, sociale, kulturore, psikologjike, etj.

Faktori i shpeshtë është ai ekonomik, ku hyjnë shkaqet si papunësia e lartë, e cila mund të ndikojë drejtpërdrejt në krijimin e problemeve të çiftet, rrogat e ulëta dhe të ardhurat minimale që shoqërohen me konflikte rreth mënyrës së menaxhimit të tyre (Friedberg & Stern, 2003), mungesa e hapësirës banesore dhe të detyruarit e jetesës në bashkësi familjare më të gjera, migrimi në shtetet e huaja e njërit prej partnerëve për të fituar të drejtën e qëndrimit dhe të drejtën e punës (Philopov, 2003), apo edhe shkurorëzimi me marrëveshje mes bashkëshortëve për të lidhur martesë me shtetas të huaj për të fituar këto të drejta (Musliu, 2010), pamundësia e realizimit të mënyrës së parapëlqyer të jetesës e cila është mjaft e përhapur edhe në vendet e tjera të Evropës, sipas një studimi të bërë nga Wagner M. and Weiss B. (2004), etj.

Tek arsyet sociale vjen në shprehje arsimimi, përkatësisht rritja e nivelit të edukimit të gruas në shoqëri, pabarazitë gjinore ku në pozitë më të pafavorshme janë femrat, dhuna fizike dhe psikike, jetesa në bashkësi familjare të gjera, pamundësia për të pasur fëmijë, qasja gjithëpërfshirëse në të arriturat teknologjike (interneti-përdorimi i rrjeteve sociale, telefonia mobile etj.), varësitë nga substancat narkotike, varësitë nga alkooli, varësitë nga bixhozi dhe lojërat e fatit, etj.

Disa arsye të tjera relevante që kanë pasojë shkurorëzimin në Komunën e Ferizajt janë hyrja në bashkësi martesore e partnerëve të papjekur, mungesa e komunikimit të bashkëshortët, tradhtia, ndryshimet e individit dhe evoluimi i personalitetit, problemet psikologjike si stresi dhe depresioni (Selmani, 2012), etj. Mjaft autorë e kanë analizuar divorcin edhe në raport me integrimin në komunitetin fetar, me shkallën e besimit, kjo gjithsesi është ndikim i karakterit moral, emocional dhe psikologjik.

Pas ndarjes, shkurorëzimi ndaj bashkëshortëve ka pasojat lidhur me mbiemrin, trashëgiminë (Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, 2005), ndarja e pasurisë së përbashkët, alimentacioni, çështja e banimit, dëmshpërblime të dëmeve eventuale, etj. Ligji për Familjen i Kosovës rregullon marrëdhëniet pas shkurorëzimit për pasurinë e përbashkët, sendet e luajtshme, mbrojtjen e pasurisë së fëmijëve. Në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët atëherë, pasoja shumë të mëdha barten edhe tek ata. Përveç efekteve psikologjike që krijon shkurorëzimi i prindërve të fëmijët, vendosja për ushqimin, ruajtjen, kujdesin dhe edukimin e tyre është situatë që drejtpërdrejt i prekë ata (Podvorica, 2006). Në rastet kur nuk arrihet marrëveshja e përbashkët mes bashkëshortëve për çështjen e ndarjes së fëmijëve, atëherë vendimin e sjell gjykata.

Hipotezat e vendosura lidhur me këtë hulumtim janë:

Hipoteza: Shkak kryesor i shkurorëzimeve është niveli i ulët integritetit social. Si dhe hipotezat ndihmëse se shkaqet relevante të shkurorëzimit janë të natyrës ekonomike dhe efektet negative që sjellin. Dhe pasojat më të mëdha të shkurorëzimeve barten të fëmijët (në rastet kur të shkurorëzuarit kanë fëmijë të përbashkët).

Objektivat e këtij hulumtimi janë:

- Të zbulohen rrethanat dhe arsyet më të shpeshta të shkurorëzimit në Komunën e Ferizajt.
- Kush janë më të afektuar nga shkurorëzimi?
- Si i trajton shoqëria të shkurorëzuarit, dhe sa vështirë është të krijojnë statusin “e qëndrueshëm” social?
- Sa ndikojnë pasojat e shkurorëzimit në rritjen e fëmijëve?
- Cilat janë konfliktet që mund të kenë bashkëshortët pas shkurorëzimit?

Metodologjia:

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim do të bazohet në analizën e legjislacionit që rregullon këtë fushë përfshirë Ligjin për Familjen, Të Drejtën Familjare dhe norma të tjera ligjore. Gjithashtu ky kërkim do të fokusohet në shqyrtimin e raporteve dhe hulumtimeve të bëra për shkurorëzimin në shoqërinë tonë. Do të analizohen të

dhënat zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe të dhëna të tjera nga Gjykata themelore e Ferizajt, Qendra për Punë Sociale rreth shkurorëzimeve që kanë ndodhur. Përveç kësaj, do të realizohen intervista si metoda të kërkimit e cila do të përdoret për të nxjerrë të dhëna dhe informacione që nuk mund të njihen përmes dokumenteve, raporteve, statistikave, etj. Lloji i intervistës që do të përdoret do të jetë intervista e lirë, e standardizuar të cilën do ta përdorim duke respektuar etikën e kërkimit. Intervista do të realizohet me bashkëshortë të shkurorëzuar, zyrtarë të gjykatës, punëtorë të Qendrës Sociale.

Të shkurorëzuarit e intervistuar për këtë hulumtim kanë qenë banorë në Komunën e Ferizajt, dhe përzgjedhja e tyre është bërë në bazë të informacione për identifikimin këtyre rasteve. Të intervistuarit u janë përgjigjur 17 pyetjeve të parashtruara, për grumbullimin e të dhënave. Intervista në Gjykatën Themelore të Ferizajt është realizuar me zyrtarë që merren me lëndët e shkurorëzimit dhe janë përgjigjur në 17 pyetjeve të parashtruara. Edhe në Qendrën Sociale është realizuar intervistë me punonjës të këtij institucioni që janë përgjigjur në 16 pyetje të parashtruara.

Të dhënat dhe analiza

Për të kuptuar sa më mirë dhe për të krijuar një pasqyrë të saktë për disa aspekte të shkurorëzimit, se cilët janë faktorët që qojnë deri te ndërprerja e martesës, dhe cilat janë efektet që shkaktojnë ato te të shkurorëzuarit, fëmijët e të shkurorëzuarve, familjarët dhe sa ndikon shkurorëzimi në jetën sociale dhe integrimin në shoqëri, kemi përdorur si metodë intervistën.

Për të kërkuar arsyet e shkurorëzimit janë intervistuar 10 persona të identifikuar të cilët kanë bërë prishjen e martesës me shkurorëzim. Këta respodentë janë përdorur si mostër e personave që kanë bërë shkurorëzimin dhe përmes intervistës janë identifikuar saktësisht arsyet dhe efektet që ka pasur shkurorëzimi në të jetën e tyre. Intervista që u është bërë të shkurorëzuarve ka përmbajtur 17 pyetje. Pyetjet e para kanë qenë rreth marrjes së informatave të kohëzgjatjes

së martesës, rreth bërjes së kërkesës për shkurorëzim dhe kundërshtimit të saj.

Një tjetër faktor që ka qenë me interes të identifikohet ka qenë mosha e personave që kanë bërë shkurorëzimin si dhe niveli i arsimimit dhe statusi i punësimit të tyre, pasi supozohet se këta faktorë janë indikatorë të mëdhenj të prishjes së martesës në shoqërinë tonë. Intervista më tej ka përmbajtur pyetjet rreth arsyeve të ndarjes së bashkëshortëve duke ju kërkuar të sqarojnë se pse ka ndodhur shkurorëzimi.

Procesi i prishjes së martesës me shkurorëzim padyshim që është një moment dhe një zhvillim shumë i vështirë për këta persona. Përmes pyetjeve të parashtruara është bërë identifikimi i vështirësive që kanë kaluar gjatë shkurorëzimit, si janë trajtuar në shoqëri dhe me çfarë problemesh apo situatash janë përballur të shkurorëzuarit gjatë këtij procesi dhe më pas në Komunën e Ferizajt.

Përveç ndikimit të shkaktuar te këta persona, shkurorëzimi padyshim prek edhe persona të tjerë si anëtarët e familjes dhe në veçanti fëmijët që kanë prind të shkurorëzuar (Mandro, 2009). Përmes intervistës është bërë identifikimi i personave që kanë fëmijë me ish bashkëshortin/en, është identifikuar mosha e fëmijëve kur ka ndodhur shkurorëzimi dhe mosha që kanë tani. Për fëmijët që kanë prind të shkurorëzuar është shumë i rëndësishëm kujdesi, mbajtja, edukimi dhe ushqimi i tyre. Cili prej tyre e ka këtë të drejtë, dhe si është e organizuar rritja e fëmijëve, ka qenë objektiv me theks të veçantë pasqyrimi përmes intervistës.

Për personat që kanë bërë shkurorëzim me ish partnerin/en që kanë fëmijë të përbashkët, marrëdhënia e tyre pas shkurorëzimit ka pasur një relevantë gjatë intervistave, pasi këtu kemi të bëjmë me pasojat e mundshme që barten te fëmijët me prind të ndarë në rritjen e tyre, edukimin, jetën sociale, në mirëqenien e tyre në përgjithësi.

Fokusi i gjetjes së efekteve dhe pasojave pas shkurorëzimit tek të shkurorëzuarit ka qenë i përqendruar edhe në gjendjen apo qëndrueshmërinë ekonomike të tyre. Duke pasur parasysh situatën ekonomike, nivelin e papunësisë, të ardhurat e vogla në Komunën e Ferizajt, të intervistuarve u është parashtruar edhe pyetja se çfarë vështirësish ekonomike kanë pasur pas shkurorëzimit dhe sa ia dalin

këta persona t'i mbulojnë shpenzimet dhe të ofrojnë jetë mesatarisht të kënaqshme edhe për fëmijët e tyre. Përveç faktorit ekonomik, është analizuar edhe efekti i shkurorëzimit në aspektin social. Si i trajton shoqëria jonë, sa pranohen në rrethe sociale, sa e kanë të vështirë integrimin e tyre, kanë qenë pyetje që të intervistuarit u janë përgjigjur.

Pyetjet e fundit kanë pasur të bëjnë me periudhën e pas shkurorëzimit. Të intervistuarit janë përgjigjur nëse do të ktheheshin me partnerin e tyre, dhe nëse ata apo partneri i tyre kanë hyrë në lidhje martesore me persona të tjerë.

Përveç intervistës me të shkurorëzuar, janë realizuar edhe intervista me zyrtarë të Gjykatës Themelore të Ferizajt. Kjo, për shkak të vështirësisë dhe natyrës së ndjeshme të çështjes së hulumtimit për të marrë informata drejtpërdrejt nga të shkurorëzuarit. Intervista është realizuar me zyrtarë që janë të informuar dhe me qasje në lëndë të tilla. Janë parashtruar pyetje rreth shkaqeve më të shpeshta për prishjen e martesës me shkurorëzim, bashkëpunimi i bashkëshortëve gjatë shkurorëzimit, shpenzimet që bëhen për shkurorëzim, numri i grave dhe burrave që parashtrojnë kërkesën apo padinë. Prej këtij institucioni janë kërkuar edhe të dhëna rreth fëmijëve si personat më të afektuar prej shkurorëzimit, rreth mbajtjes së tyre gjatë këtij procesi, rreth marrjes së vendimit se kush fiton të drejtën e mbajtjes, kujdesit dhe ushqimit të fëmijëve, rolin e të afërmeve dhe familjarëve të të shkurorëzuarve në këtë proces, ushtrimi i dhunës fizike dhe psikike ndaj personave të shkurorëzuar, përfshirja e policisë në këto raste për intervenime të caktuara, ndihma juridike apo shërbimet konsultuese falas për të shkurorëzuarit.

Gjatë intervistimit janë kërkuar edhe informata rreth fenomeneve si "shkurorëzimet me marrëveshje" mes bashkëshortëve me qëllim të përfitimit të lejes së qëndrimit, apo të lejes së punës jashtë vendit, dhe të identifikimit të rasteve të prishjes së martesës mes qytetarëve të Ferizajt dhe personave të huaj.

Një intervistë tjetër e realizuar për të arritur të dhëna ka qenë edhe ajo e realizuar në Qendrën Sociale të Komunës së Ferizajt. Prej këtij institucioni është bërë përpjekje të nxirren të dhëna më shumë rreth pasojave dhe efekteve të shkurorëzimit. Qendra për Punë Sociale

ballafaqohet me shumë raste të shkurorëzimit, dhe realizimi i intervistës me zyrtarë të këtij institucioni ka qenë me relevancë për të zbërthyer dhe për të kuptuar më shumë efektet pas shkurorëzimit. Kjo qendër na ka ofruar përgjigje rreth pyetjeve tona si - ndikimi i shkurorëzimit në familjarët e të shkurorëzuarve dhe anasjelltas, kujdesi dhe mbajtja e fëmijëve kur të dy prindërit për shkak të rrethanave të ndryshme e kanë të pamundur këtë, rastet kur bashkëshortët jetojnë të ndarë, pa e bërë shkurorëzimin “de jure” dhe pasojat që ka kjo situatë. Ndikimi të fëmijët në aspektet si edukimi i tyre, sjellja e tyre në shoqëri, gjendja emocionale dhe psikike.

Pas realizimit të intervistave me secilin prej respondentëve është bërë analiza manuale e tyre. Përveç të dhënave bazë si gjinia, mosha, arsimimi, punësimi që janë paraqitur grafikisht, ato edhe janë përpunuar përmes Excel. Për shkak se të dhënat e nxjerra kanë qenë të dhëna cilësore përpunimi i tyre ka qenë i natyrës së tillë. Është bërë krahasimi i të dhënave mes të intervistuarve të shkurorëzuar, identifikimi i përgjigjeve të përbashkëta prej tyre, është bërë një pasqyrë e përbashkët e përgjigjeve të tyre, për të nxjerrë në pah aspektet më me interes për këtë hulumtim.

Intervistat e realizuara me institucionet e përfshira dhe të lidhura drejtpërdrejt me shkurorëzimet në Komunën e Ferizajt janë përpunuar në të njëjtën formë, për shkak të llojit dhe mënyrës së marrjes së të dhënave. Përgjigjet e tyre janë integruar në tekst, janë krahasuar më të dhënat që tash më i kemi pasur, dhe me të dhënat zyrtare që kanë ofruar këto institucione përmes burimeve zyrtare.

Gjetjet:

Intervista me të shkurorëzuar:

Në fillim të intervistës me secilin prej respondentëve të shkurorëzuar, janë nxjerrë të dhënat rreth gjinisë, moshës, nivelit të arsimimit dhe statusit të punësimit. Këto informata, për pasqyrë më të qartë janë të paraqitura grafikisht më poshtë.




Figura 1. Të dhënat në bazë të gjinisë së të intervistuarve.

Prej personave të intervistuar 60% e tyre kanë qenë meshkuj dhe 40% kanë qenë femra. Përzgjedhja e tyre është munduar të bëhet sa më e barabartë për shkak të cilësisë së të dhënave të nxjerra.




Figura 2. Të dhënat në bazë të moshës së të intervistuarve.

Sipas të dhënave, më shumë të intervistuar kanë qenë personat mes moshës 26-33 vjet përkatësisht 64% e tyre, duke lënë pas grup-moshat e tjera.




Figura 3. Të dhënat për statusin e punësimit të të intervistuarve.

Për shkak se statusi i punësimit ka një ndikim dhe konsiderohet si një ndër faktorë me relevantë për shkurorëzim, janë marrë informata edhe prej respondentëve, ku 80% prej tyre janë të punësuar, ndërsa 20% prej tyre jo.




Figura 4. Të dhënat për shkallën e arsimimit të të intervistuarve.

Arsimimi si një tjetër faktor i rëndësishëm, prej respondentëve tanë kanë qenë 50% me arsim të mesëm, duke lënë pas 30% me arsim të lartë, dhe 20% me arsim pas universitar.

Të intervistuarit kanë qenë të pyetur edhe rreth kohëzgjatjes së martesës së tyre, prej tyre janë marrë këto përgjigje të paraqitura si më poshtë:




Figura 5. Të dhënat për kohëzgjatjen e martesës së intervistuarve.

Pra, 70% e të intervistuarve kanë qenë në martesë me ish bashkëshortin/en në kohëzgjatje prej 1 vjet deri në 5 vjet, duke lënë pas kohëzgjatjet e tjera të martesave.

Ndërsa të dhënat se sa prej respondentëve kanë fëmijë të përbashkët me ish-bashkëshortin/en janë se 70% të intervistuarve kanë fëmijë ndërsa 30% jo. Kërkesën për shkurorëzim sipas përgjigjeve të marra e kanë parashtruar 80% të respondentëve ku 20% prej tyre kanë hasur në kundërshtimin e kërkesës nga ana e ish burrit apo gruas. Vetëm një respondent nuk e ka parashtruar kërkesën për shkurorëzim dhe e ka bërë kundërshtimin e kërkesës së ish-bashkëshortit/es.

Pyetja që u është parashtruar të gjithë personave të shkurorëzuar që janë intervistuar ka të bëjë me shkakun pse ka ndodhur shkurorëzimi. Nga vëzhgimi që kemi bërë gjatë intervistave, të gjithë personat që janë përgjigjur kanë hezituuar të sqarojnë gjerësisht arsyen pse ka ardhur deri te ndarja me ish-bashkëshortin/en. Ne kemi marrë përgjigjen rreth arsyes apo faktorit kryesor që ka ndikuar në prishjen e martesës. Prej të dhënave të marra 20% e respondentëve kanë paraqitur tradhtinë nga ish-partneri/ja si arsyen e ndarjes apo prishjes së

martesës së tyre, 20% kanë sqaruar se jetesa në shtete të ndryshme e partnerëve, për shkak të punës apo përpjekjes për sigurimi të lejes së qëndrimit në shtetet e BE ka qenë një faktor që ka sjellë shumë mosmarrëveshje, konflikte, dhe situata të tjera ku janë përfshirë edhe familjarët e tjerë që kanë shkaktuar prishjen e martesës.

Përgjigje të tjera që mund të hyjnë në faktorët ekonomikë që sjellin probleme në martesë kemi marrë edhe nga 20 % e respondentëve të tjerë, ata kanë paraqitur faktin që jetesa në bashkësi familjare të gjera ka qenë shkaktari kryesor i ndarjes. Pamundësia për shkak të kushteve ekonomike të dobëta për të jetuar ndaras nga bashkësia e gjerë familjare e burrit ka sjellë mosmarrëveshje dhe konflikte jo vetëm mes çiftit, por edhe në raport me familjarët e tjerë, që si rezultat ka pasur edhe prishjen e martesës së dy prej të intervistuarve. 40% e respondentëve të tjerë shkaktar kryesor të shkurorëzimit kanë pasur mosmarrëveshjet e vazhdueshme, dallimin në pikëpamjet dhe organizimin e jetesës në martesë dhe zënka apo konflikte të shpeshta. Në 20% të rasteve të intervistave të realizuara që kanë paraqitur faktorin kryesor mosmarrëveshjet mes tyre për shkurorëzim, kanë theksuar faktin se këto konflikte kanë filluar për shkak se gruaja ka filluar të punojë, dhe për këtë fakt kanë filluar të gjitha problemet.

Intervista e të shkurorëzuarve ka nxjerrë në pah edhe njohuri se cila ka qenë pjesa me vështirësitë më të mëdha gjatë shkurorëzimit. Vlen të theksohet se në të gjitha rastet ku të shkurorëzuarit kanë fëmijë të përbashkët, situatat më të rënda i kanë rreth fëmijëve. Ata kanë vështirësi në sqarimin e situatës fëmijëve se përse ka ndodhur ndarja, në përballjen me ta, në takimet me fëmijët, në vendosjen se kush do të mbajë fëmijët, në angazhimin dhe përkujdesjen e tyre në ndarjen prej tyre në raste të caktuara dhe situata të tjera.

Momente të tjera që cilësohen si të pakëndshme janë edhe përballja me familjarët, e sidomos e grave të shkurorëzuara. Të gjitha femrat e intervistuarat tregojnë që ka qenë shumë e rëndë për to të ballafaqohen me familjarët e tyre.

Në vendin tonë është e njohur dukuria që ndarjet të bëhen edhe me takimin e familjarëve të çiftit që janë të gjinisë mashkullore, përveç me anë të procesit gjyqësor. Këto raste kanë shkaktuar edhe përfshirje

dhe ndërhyrje të personave të tjerë për shkurorëzimin, që padyshim është shumë e rëndë për të shkurorëzuarit.

Disa prej të intervistuarve kanë potencuar se edhe takimi më ish-bashkëshortin/en ka qenë i vështirë, pasi partnerët e tyre kanë kundërshtuar kërkesën për shkurorëzim dhe kanë kërkuar bashkimin e tyre. Të tjerë në përgjigje të kësaj pyetje kanë pohuar se zhvendosja në banesë të re dhe gjetja e një pune ka qenë shumë e vështirë duke pasur parasysh mundësitë e punësimit dhe realizimit të të ardhurave në vendin tonë.

Nga të dhënat e nxjerra, prej të intervistuarve të cilët kanë fëmijë me ish-bashkëshortin/en në të gjitha rastet gruaja ka të drejtën për të mbajtur, kujdesur dhe ushqyer fëmijët me kujdestari të plotë, përveç një rasti të vetëm ku babai e ka këtë të drejtë.

Në kohën kur ka ndodhur shkurorëzimi prej 87.50% e rasteve të të intervistuarve që kanë fëmijë të përbashkët, fëmijët e tyre kanë qenë të moshës prej 0 deri në 5 vjet, ndërsa 12.50 % kanë qenë me fëmijë të moshës 21 deri në 24 vjet.

Të intervistuarit që kanë fëmijë të përbashkët me ish-bashkëshortin/en janë pyetur edhe se çfarë ndikimi ka pasur shkurorëzimi në jetën e fëmijëve të tyre. Të gjithë këta prindër janë përgjigjur se ka pasur ndikim emocional tek të gjithë fëmijët, përveç në raste të cilët i kanë pasur fëmijët prej moshës 0 deri 1 vjet dhe nuk e kuptojnë ende situatën. Të gjithë prindërit e tjerë theksojnë se shkurorëzimi te fëmijët e tyre ka shkaktuar jo-stabilitet emocional, konfuzitet, kërkesë për t'u bashkuar prapë prindërit, dhe afërsi më të madhe me prindin i cili ka të drejtën për mbajtjen e tyre në raport me prindin tjetër.

Sa ka ndikuar shkurorëzimi në gjendjen ekonomike të të shkurorëzuarve? Të intervistuarit që kanë qenë të papunësuar, pra 20 % e tyre janë deklaruar që e kanë të dobët qëndrueshmërinë ekonomike, pasi nuk kanë punë të qëndrueshme dhe kërkojnë në vazhdimësi pavarësi ekonomike nga familjarët, apo edhe ish-bashkëshorti/ja në rastet kur kanë fëmijë të përbashkët. Ndikim jo të theksuar kanë deklaruar të intervistuarit që nuk kanë fëmijë, ata janë përgjigjur se shkurorëzimi nuk ka ndikuar aspak në qëndrueshmërinë e tyre ekonomike. 80% e të intervistuarve janë të punësuar, mirëpo

prapë paraqesin vështirësi në mbulimin e shpenzimeve, pasi tani më nuk punojnë dy anëtarë të familjes, por vetëm njëri, dhe shpenzimet janë më të larta se sa kur kanë qenë në bashkësi martesore.

Tjetër pyetje e parashtruar ka qenë edhe se sa ka ndikuar shkurorëzimi në jetën sociale të tyre, në integrimin në shoqëri. E paraqitur edhe më lart grafikisht, 60% e të intervistuarve kanë qenë meshkuj, dhe të gjithë prej tyre në këtë pyetje janë përgjigjur që shkurorëzimi nuk është se ka ndikim të theksuar në aspektin social dhe integrimin të tyre në shoqëri. Për dallim prej tyre, femrat e shkurorëzuara, përveç hezitimit dhe mungesës së dëshirës për të biseduar rreth integrimin të tyre në shoqëri, kanë thënë se janë të lidhura me të afërmit dhe familjarët e tyre, apo vetëm me shoqëri të ngushtë. Disa prej femrave të shkurorëzuara pranojnë se ndjehen keq ndonjëherë për shkak të komenteve të ndryshme rreth ndarjes së tyre nga shoqëria.

Pas shkurorëzimit, për ish-bashkëshortët/et që nuk kanë fëmijë të përbashkët është shumë e lehtë shkëputja e kontaktit dhe marrëdhënies shoqërore mes tyre, për dallim prej atyre që kanë fëmijë të cilët janë të detyruar për shkak të fëmijëve të komunikojnë, të takohen, dhe të marrin vendime të përbashkëta rreth fëmijëve. Kjo kategori realizon komunikim dhe takime për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët e tyre, ku përveç kësaj ndonjëherë lindin edhe mosmarrëveshje, si p.sh. kërkesa nga ana e prindit që nuk e ka kujdestarinë e plotë për të qëndrim më të gjatë me fëmijët, kërkesë nga ana e njërit prej të shkurorëzuarve për t'u bashkuar përsëri, ndërhyrje dhe konflikte mes familjarëve të çiftit, e të tjera.

Në pyetjen se si kanë hyrë në lidhje martesore, të intervistuarit janë përgjigjur në këtë formë të paraqitur grafikisht më poshtë.



Figura 6. Të dhënat për hyrjen në lidhje martesore e të intervistuarve.

Respondentët janë përgjigjur edhe në pyetjen se a do të ktheheshin përsëri bashkë me ish-bashkëshortin/en, përgjigjet e marra janë të paraqitura si më poshtë:




Figura 7. Të dhënat e paraqitura për pyetjen nëse të intervistuarit do të bënin rikthim me ish-bashkëshortin/en apo jo.

Të intervistuarit janë pyetur edhe nëse kanë hyrë në lidhje tjetër martesore ata apo ish-bashkëshortët-et e tyre, ku janë përgjigjur si më poshtë:




Figura 8. Të dhënat për hyrjen në lidhje martesore pas shkurorëzimit e të intervistuarve.

Intervista në Qendrën Sociale

Përveç grumbullimit të të dhënave përmes intervistës së realizuar me të shkurorëzuar në Komunën e Ferizajt, ne kemi realizuar edhe intervistë në Qendrën për Punë Sociale në Komunën e Ferizajt. Sipas këtij institucioni, janë të shumta rastet e konflikteve të martesës të cilët kanë ndërhyrë të afërmit dhe familjarët. Të dhënat theksuan se ndërhyrja e prindërve është shumë e shpeshtë në shumë raste. Në të gjitha këto raste pas ndarjeve çrregullohen në masë të madhe familjet e të shkurorëzuarve, duke i hedhur fajin njëri tjetrit, apo edhe duke krijuar konflikte të tjera.

Sipas këtij institucioni, pasojat e shkurorëzimit të të shkurorëzuarit në radhë të parë janë pasojat në gjendjen shëndetësore dhe emocionale, në gjendjen socio-ekonomike, çrregullimet të familja e ngushtë, stigmatizimi që iu bëhet të shkurorëzuarve nga ana e rrethit dhe shoqërisë, etj. Më tej shtohet se gruaja është ajo e cila ndikohet më shumë se burri me rastin e prishjes së martesës, duke theksuar se ndikimi në gjendjen psikike dhe emocionale paraqitet shumë të të shkurorëzuarit e sidomos të gruaja. Kjo përcillet me një ankth dhe frikë se si do t'ia dalë pasi që i mungon përkrahja si nga rrethi familjar

po ashtu edhe nga ai shoqëror. Përcillet po ashtu me trauma dhe strese të ndryshme dhe me një mosbesim ndaj gjinisë së kundërt.

Ndikim më i theksuar te gruaja shfaqet edhe në aspektin ekonomik, pasi në të shumtën e rasteve gruaja e ka të pazgjidhur çështjen e pavarësisë ekonomike.

Pasi pasojat më të mëdha më së shpeshti i vuajnë fëmijët, ne kemi marrë edhe qëndrimin e Qendrës Sociale rreth kësaj situatë duke pasur parasysh rolin që ka ky institucion në rregullimin e këtyre marrëdhënieve.

Sipas gjetjeve shkurorëzimi në jetën emocionale dhe psikike të fëmijëve manifestohet me hiperaktivitet të madh, me një pasiguri në vetvete, me reagime të shumta emocionale. Fëmijët hidhërohen lehtë, kanë lodhje fizike, e përjetojnë ndjenjën se janë fajtorë ata, kanë një gjendje paniku dhe konfuzioni. Fëmijët e kësaj kategorie devijojnë, te ta manifestohen sjelljet asociale dhe delikvente, e sidomos nëse të njëjtët e kanë përjetuar një dhunë të vazhdueshme në familje.

Sa i përket ndikimit të ndarjes së prindërve në edukimin e fëmijëve, në përgjithësi këta fëmijë kanë arritje më të ulëta në shkollë. Ata nuk janë të lumtur në familje dhe shfaqen më të pa interesuar në shoqëri e në rrethin ku jetojnë se sa fëmijët me familje të plotë. Ndikimi negativ i ndarjes te fëmijët paraqitet më shumë gjatë vitit të parë dhe vitit të dytë pas ndarjes dhe më pas të me kalimin e kohës, këto ndikime shënojnë zbehje.

Në shoqërinë tonë rastet kur bashkëshortët jetojnë të ndarë, pa e bërë shkurorëzimin “de jure” janë të shpeshta. Tek Qendra Sociale në Komunën e Ferizajt referohen rastet e çrregullimeve bashkëshortore nga vetë personat, nga policia në rastet e dhunës në familje si dhe nga gjykatat të cilat kërkojnë raport për besimin e fëmijëve njërit nga prindërit. Ky institucion është i vetëdijsëm se ka edhe raste të tilla që prindërit jetojnë ndaras pa e bërë shkurorëzimin. Në këto raste pasojat janë shumë të mëdha te fëmijët dhe shfaqen ndër të tjera në këto forma: mungesa e kontaktit me prindin tjetër, humbja e kontaktit me familjarët, gjendja e rëndë emocionale, ndikimi në edukimin, etj.

Ka edhe raste kur të dy prindërit për shkak të rrethanave të ndryshme e kanë të pamundur kujdesin dhe mbajtjen e fëmijëve, atëherë, nëse fëmijët kanë familjarë nga ana e babait ose nënës,

kujdestarinë e marrin personat e tretë me pranimin për të qenë kujdestarë dhe me propozim të Organit të Kujdestarisë Gjykata ua beson kujdestarinë atyre.

Ndërsa në rastet kur fëmijët nuk kanë të afërm atëherë kujdestarinë e fëmijëve e merr drejtpërdrejt Organi i Kujdestarisë në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.

Pas shkurorëzimit në rastet kur pas ndarjes fëmijët u janë besuar nënës, këto nëna nuk hyjnë në martesë me tjetër partner, ndërsa kur nënat nuk e kanë besimin e fëmijëve për përkujdesje, për shkak të rrethanave të krijuara në familje ndonjëherë detyrohen që të lidhin martesë.

Intervistë me zyrtarë të Gjykatës:

Sipas Gjykatës Themelore e Ferizajt, shkaqet më të shpeshta të paraqitura në paditë për shkurorëzim janë prishja dhe çrregullimi serioz i marrëdhënieve bashkëshortore, për shkak të shprehjes së xhelozisë dhe mos përshtatjes së edukatave. Në raste të caktuara edhe faktori ekonomik ndikon jo drejtpërdrejt, për shkak të kushteve të rënda, apo situatës së ndërlikuar për shkak të sigurimit të të ardhurave. Faktor relevant për këtë dukuri është edhe niveli i arsimimit të personave që kërkojnë shkurorëzim. Sipas informatave të marra nga ky institucion në të shumtën e rasteve ata janë me arsimim të shkollës së mesme, dhe një numër shumë i vogël prej tyre, janë të punësuar. Gjatë këtij procesi, në shumicën e rasteve bashkëshortët janë të gatshëm për bashkëpunim, pasi që 90% e rasteve janë zgjidhja e martesës me marrëveshje dhe numri i burrave dhe grave që paraqesin kërkesën për shkurorëzim është i barabartë.

Gjatë procesit të shkurorëzimit nuk kanë qasje familjarët në procesin e shkurorëzimit përveç nëse ftohen në cilësi të dëshmitarit, ndërsa fëmijët zakonisht qëndrojnë me njërin prind gjatë kësaj periudhe. Për marrjen e vendimit se kush do të mbajë, kujdeset dhe ushqejë fëmijët merren parasysh gjendja ekonomike e bashkëshortëve dhe lidhja e emocionale e krijuar mes fëmijëve dhe prindërve, gjithashtu një rëndësi të madhe ka edhe mendimi i QPS-së përkatëse, që është e njohur me rastin.

Sipas publikimeve të Agjencisë të Statistikave të Kosovës në Komunën e Ferizajt në vitin 2013 janë bërë 13 shkurorëzime, të qytetarëve të Republikës së Kosovës me shtetas të huaj. Sipas Gjykatës në Ferizaj ka shumë raste të tilla dhe personat e huaj janë nga vendet si Polonia, Gjermania, Bullgaria etj. Kjo dukuri është e njohur në vendin tonë, si tendencë e shtetasve të Republikës së Kosovës, për të lidhur martesë me të huaj me qëllim të sigurimit të dokumentacionit si leja e qëndrimit në shtete përkatëse apo leja për të punuar.

Padyshim që shkurorëzimi është një moment i vështirë për të gjithë personat që e bëjnë, e sidomos në shoqërinë tonë, dhe në vendin tonë nuk ekziston ndonjë formë e ndihmës apo konsultimit juridik falas, që u ofrohet bashkëshortëve dhe sipas të dhënave nga Gjykata, ka raste të tilla, kur bashkëshortët kanë nevojë për konsultime apo këshilla, mirëpo kjo nuk është e mundur. Përveç të tjerash bashkëshortët janë të obliguar të mbulojnë shpenzimet për gjykatë, taksë në vlerë prej 40 euro si dhe shpenzimet për përfaqësim nga avokati nëse paraqitet nevoja.

Gjatë ndarjeve dhe prishjes së martesave me shkurorëzim është i shpeshtë edhe ushtrimi i dhunës fizike, apo psikike. Sipas të dhënave nga Gjykata në Ferizaj kjo ndodh në shumicën e rasteve sidomos në rastet kur bashkëshortët kërkojnë shkurorëzim me padi. Mirëpo gjatë vitit 2013 prej rasteve të prishjes së martesës me shkurorëzim në asnjë rast nuk është përfshirë edhe policia.

Diskutimet

Në Komunën e Ferizajt, femrat e shkurorëzuara janë më të ndikuara negativisht se sa meshkujt dhe ato janë më pak të integruara në shoqëri, kjo reflektohet në statusin e punësimit, niveli i arsimimit, lidhja e martesës tjetër etj.

Gjatë hulumtimit Gjykata Themelore e Ferizajt nuk ka pasur të dhëna të gatshme se sa nga vendimet për mbajtjen e fëmijëve janë në favor të nënave dhe sa vendime janë në favor të etërve, dhe përpunimi i këtyre të dhënave merr një kohë të gjatë.

Qendra për Punë Sociale nuk ka pasur të dhëna të sakta për numrin e fëmijëve me prindër të shkurorëzuar në nivelet e arsimimit si

ai parashkollor, fillor, i mesëm, për shkak të mos identifikimit të këtyre rasteve as nga institucionet shkollore apo edhe institucionet e tjera relevante.

Një pjesë e fëmijëve të shkurorëzuar që janë edhe bartës të efekteve të shkurorëzimit nuk gjejnë trajtim me psikologë të shkollave apo konsultues në institucionet e tjera.

Në Gjykatën Themelore të Ferizajt janë rreth diku 5 raste të shkurorëzimit të cilët kanë kërkuar ndihmën juridike pa pagesë dhe që janë duke pritur për këshilla juridike, e cila nuk është duke iu ofruar.

Kufizimet e studimit

Ky studim është realizuar me 10 respondentë prej personave të shkurorëzuar. Ky numër do të ishte më i madh nëse ky hulumtim do të shtrihet në komuna të tjera të Republikës së Kosovës, duke mundësuar identifikimin e më shumë çifteve të shkurorëzuar, dhe një numër më të madh të të intervistuarve.

Gatishmëria për të ofruar informata dhe për t'u përgjigjur në pyetje nga raste të ish-bashkëshortëve nuk ka qenë shumë e lehtë për t'u gjetur. Janë identifikuar edhe disa raste të tjera të shkurorëzimit në Komunën e Ferizajt, që nuk kanë pranuar të bashkëpunojnë, duke hezituuar të japin informata rreth përvojës së tyre për shkak të frikës për paragjykime ose ndonjë arsye personale.

Ky hulumtim do të mund të kishte përfshirë edhe intervistimin e personave të tjerë të afërt me të shkurorëzuarit në Komunën e Ferizajt, që shohin nga afër rastet e tilla. Këta persona do të mund të ishin familjarë, miq, kolegë pune etj., që kanë informata për situatat që ndikojnë në prishjen e martesës me shkurorëzim dhe pasojat e tij.

Përfundim

Sipas rezultateve të nxjerra nga ky hulumtim, shkaqet për shkurorëzim në Komunën e Ferizajt janë nga më të ndryshmet, kështu ata për shkak të gjendjes ekonomike si faktorëve të jetesës së njërit nga

partnerët në shtete të huaja për punë, jetesa në bashkësi familjare të gjera nga pamundësia janë 40%, për shkak të tradhtisë janë 20% dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme mes çifteve dhe pamundësia e realizimit të mënyrës së parapëlqyerit të jetesës janë 40 %. Kjo edhe vërteton hipotezën e vendosur për këtë hulumtim. Sipas gjetjeve tona, gjendja ekonomike ndikon indirekt në shkaktimin e konflikteve dhe situatave që mund të qojnë te shkurorëzimi si jetesa e ndarë e çifteve në shtete të ndryshme për shkak të mundësisë së vogël punësimit, apo sigurimit të dokumentacionit për qëndrim apo leje të punës në shtetet perëndimore, jetesa në bashkësi të gjera familjare, që qon deri te mosmarrëveshjet mes çiftit ku përfshihen edhe familjarët e tjerë, më së shpeshti anëtarët e familjes së burrit pasi bashkëshortët jetojnë me familjen e burrit.

Pozita e pafavorshme e grave në shoqërinë tonë është një tregues, i cili po të ndryshonte do të mund të ndikonte në arsyet e shkurorëzimit ashtu edhe në pasojat e saj. Femrat për dallim prej meshkujve nuk janë të sigurta në shoqëri pas shkurorëzimit, nuk janë të integruara në shoqëri, dhe paragjykimet kanë ndikim shumë të madh në këtë aspekt. Te gjitha femrat e intervistuar janë deklaruar që kanë vështirësi në përbashkëtimin me familjarët e tyre dhe të gjitha ato kanë shfaqur se janë më pak të integruara në shoqëri në krahasim me meshkujt.

Për më tepër femrat që kanë fëmijë të përbashkët me ish-bashkëshortë, e kanë të vështirë të lidhin martesë me dikë tjetër, pra asnjë nga femrat nuk ka qenë e lidhur në martesë tjetër, për dallim prej meshkujve tek të cilët shkurorëzimi në këtë aspekt nuk ka ndikim të theksuar.

Arsimimi i ulët i personave të shkurorëzuar, nivel i ulët i integritetit në shoqëri, mungesa e pavarësisë ekonomike të grave, dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme për të realizuar jetën bashkëshortore si rezultate të këtij studimi, kanë mbrojtur hipotezat e vendosura.

Te rastet e të shkurorëzuarve që janë me fëmijë të përbashkët me ish-partnerët e tyre të gjitha nënat kanë në favor vendimin për mbajtjen, kujdesin dhe ushqimin e fëmijëve, përveç një rasti të vetëm ku babai e ka këtë të drejtë.

Fëmijët e përbashkët të martesave të prishura me shkurorëzim, ndikohen më së shumti. Ky ka qenë një parashikim tjetër i vendosur në një hipotezë, dhe nga rezultatet e gjetura përmes këtij studimi kjo edhe është vërtetuar. Impakti negativ në gjendjen emocionale, në gjendjen psikike, në rezultatit e edukimit të tyre, përshtatja me mënyrën e të jetuarit me prindër të ndarë është i pa evituar në të gjitha rastet. Kjo situatë është e theksuar sidomos për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare. Të gjitha rastet e të shkurorëzuarve të intervistuar që kanë pasur fëmijë të përbashkët kanë theksuar se vështirësia më e madhe ka qenë përballja me fëmijët dhe trajtimi i tyre. Vlen të theksohet se në këto raste është theksuar edhe jo qëndrueshmëri ekonomike edhe te personat e punësuar sikurse ata të papunësuar, për shkak të realizimit të kërkesave të fëmijëve.

Referencat:

Mandro A., (2009) *E drejta familjare*. Tiranë.

Podvorica H., (2006) *E drejta familjare*. Prishtinë, Rominor.

Musliu J. (2010) *Kosovars Turn Blind Eye to Fake Foreign Marriages*, marrë nga <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovars-turn-blind-eye-to-fake-foreign-marriages>

Arta Selmani (2012) *Pro-bono legal aid in divorce process*, marrë nga http://www.seeu.edu.mk/files/research/ProBono_LegalAid.pdf

Friedberg L. & Stern s., (2003) *The Economics of Marriage and Divorce*, University of Virginia

Philipov D.,(2003). *Major trends affecting families in Central and Eastern Europe*. In: *Major Trends Affecting Families*, The Programme on the Family, United Nations, New York.

Wagner M. and Weiss B., (2004), *On the variation of divorce risks in Europe: a meta-analysis*. University of Cologne, Germany

Ligji për Familjen i Kosovës, Nr. 2004/32, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës

Ligji për Trashëgiminë e Kosovës, Nr. 2004/26, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës

Agjencia e statistikave të Kosovës, (2014) *Seria 5: Statistikat sociale, Statistikat e shkurorëzimeve 2013*

Agjencia e statistikave të Kosovës, (2013) *Seria 4: Statistikat sociale, Statistikat e shkurorëzimeve 2012*